

Prokurimi publik i gjelbër (PPGJ) është një mjet vullnetar i politikës mjedisore që mund të mbështesë qasjen miqësore me mjedisin për aktivitete të përditshme si ofrimi i pijeve freskuese, evente të hapura, ngjarje sociale, trajnime, etj. Mund të ndikojë në prodhimin e mbetjeve, si dhe në menaxhimin e mbetjeve miqësore me mjedisin dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, në zhvillimin e infrastrukturës së mbetjeve në vend.

Prokurimi publik i gjelbër gjen zbatim duke përfshirë kritere specifike në kërkesat e prokurimit si në specifikimin teknik të objektit të prokurimit, ashtu dhe në kriteret e vlerësimit të ofertave. Të dyja metodat synojnë të marrin një produkt që është më miqësor ndaj mjedisit sesa produktet konvencionale.

Kriteret e gjelbra mund të zbatohen në të gjitha fushat e aktiviteteve të ofruara nga pushteti vendor. Megjithatë, është më mirë të nisesh me aktivitetet e përditshme si ushqimi dhe pijet, furnizimet e zyrës ose organizimi i eventeve publike.

Kur përballemi me problemin e mbetjeve plastike si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, është thelbësore të zgjedhim burimet më të rëndësishme të mbetjeve plastike dhe mundësitë për menaxhimin e këtyre mbetjeve sa më tepër miqësore me mjedisin. Mbetjet plastike prodhohen në të gjithë sektorët dhe në çdo aktivitet si: ushqim dhe katering, tekstile, ndërtim, paketim por edhe në shumë sfera të tjera. Bazuar tek gjendja aktuale e infrastrukturës së mbetjeve në Shqipëri është e rëndësishme të fokusohemi në parandalimin e mbetjeve plastike dhe ripërdorimin e tyre.

Disa nga fushat në të cilat është e mundur të reduktohet sasia e mbetjeve plastike të gjeneruara në aktivitetet e autoriteteve kontraktore janë:

- a) shërbimet e hotelerisë, ushqim
- b) shërbimet e shitjes,
- c) parandalimi i paketimit,
- d) aktivitetet e zyrës,
- e) ndërtimi,
- f) veprimtari publike dhe të tjera.

Në këtë broshurë mund të gjeni shembuj të kriterëve të mundshme të gjelbra për parandalimin e mbetjeve plastike të cilat mund të aplikohen në proceset e blerjeve në nivelin e bashkive.



Kriteret për shërbimin e pijeve dhe katering

Shmangni artikujt njëpërdorimsh (mbulesë tavoline, pipa, trazues, mbrojtëse për tabaka, etj).

Siguroni ujë rubineti (me ose pa sistem filtrimi) në vend të ujit të ambalazhuar.

Siguroni pije nga makineritë (në gota apo filxhanë të ripërdorshëm) sesa në paketime individuale.

Preferoni përdorimin e erëzave (sheqer, kripë, piper, salca, etj.) dhe setet e servisjes në enë të ripërdorshme, ku parandalimi i mbetjeve ushqimore, higjiena e ushqimit, siguria e konsumatorit dhe interesi i shëndetit publik lejojnë përdorimin e tyre.

Kërkoni setin e tavolinës të ripërdorshëm, si (enë qelqi, takëme) dhe mbulesa tavoline.

Blini produkte të freskëta dhe të stinës me paketim minimal.

Kërkoni paketim të riciklueshëm aty ku është e mundur, me kusht që paketimi të garantojë sigurinë dhe higjenën e ushqimit. Paketimi i riciklueshëm përfshin paketime të kompostueshme.

Kërkoni që artikujt e ripërdorshëm ose artikujt njëpërdorimësh të përmbajnë një përqindje të përmbajtjes së ricikluar.

Kthejeni paketimin për ripërdorim kur është e mundur dhe e rëndësishme për mjedisin.

Kërkoni nga kontraktorët që të bëjnë grumbullimin e vecuar të mbetjeve të prodhuara gjatë shërbimit.

Kërkoni përdorimin ei disa koshave të mbeturinave për ndarjen në burim të mbetjeve sipas udhezimeve.

Kërkoni një listë të përpunuesve të mbetjeve ushqimore në zonë, ndërkohë që kërkoni kompostimin para depozitimit.

Kriteret për shërbimet e shitjes

Hiqeni shishen e ujit nga makina shitëse dhe siguroni ujë rubineti (me ose pa sistem filtri) të lidhura me rezervuare furnizuese dhe që lejojnë rimbushjen e shisheve të ripërdorshme.

Zëvendësoni burimet shatërvan me burime uji (me ose pa sistem filtrimi) të lidhur me furnizues uji dhe që lejojnë rimbushjen e shisheve të ripërdorshme.

Kërkoni që shërbimi për pijet e nxehta të mos jepet me filxhanë njëpërdorimësh ose të lejojnë zgjedhjen me ose pa filxhan (duke qenë para faktit që nuk kanë zgjedhje kurdo që është e mundur) dhe me një çmim ekstra për filxhanin.

Kërkoni kafe me kokërr (jo kapsula).

Zëvendësoni gotat plastike të disponueshme me gota nga lëndë të para të kompostueshme ose të rinovueshme. Kjo duhet të kërkohet vetëm nëse instalimi i menaxhimit të mbetjeve mund të trajtojë materiale të tilla (për informacion të mëtejshëm shihni Hapin 2 të udhëzimeve). Për kompostimin, kërkoni që materialet të jenë në përputhje me standardin EN 13432 ose ekuivalentin, për të shmangur pretendimet e rreme.

Zëvendësoni pipat plastike me shkopinj nga lëndë të para të kompostueshme, të biodegradueshme ose të rinovueshme.

Kërkoni instalimin e makinerive të riciklueshme të kanaçeve dhe shisheve për ripërdorim ose riciklim.

Përfshirja e një detyrimi në kontratë të ndarjes së mbetjeve në origjinë. Është e nevojshme vendosja e disa koshave me ngjyra të ndryshme me udhëzimet përkatëse.

Përfshirja e një detyrimi në kontratë për të siguruar një menaxhim miqësor ndaj mjedisit të pajisjeve të mbeturinave (elektrike dhe elektronike) pas skadimit të tij.

Kriteret për parandalimin e paketimit

Shmangni produktet në porcione individuale ose njësi të vetme.

Shmangni paketimin oksii-plastik.

Shmangni paketimet me polisterin të zgjeruar.

Shmangni paketimet PVC dhe halogjene.

Përdorni produkte të koncentruara që mund të hollohen gjatë përdorimit, nëse është e nevojshme, në kontenerë të ripërdorshëm.

Zëvendësoni paketimin njëpërdorimsh për alternativat e rimbushjes.

Kërkoni që paketimi të jetë prej një materiali të vetëm.

Nëse paketimi nuk mund të jetë prej një materiali të vetëm, sigurohuni që paketimi të mund të ndahet lehtësisht në materiale të ndryshme, pa përdorimin e mjeteve, për të lehtësuar ndarjen dhe riciklimin e tyre.

Kërkni që paketimi të etiketohet në bazë të materialeve përbërëse, për të lehtësuar ndarjen dhe riciklimin.

Kërkoni që ambalazhi të mos jetë me ngjyrë të zezë ose të errët (vetëm në rastet kur prodhohet nga materiale të riciklueshme).

Kërkoni që ambalazhi të jetë i krijuar nga materiale të përshtatëshme për riciklim me teknologjinë e zakonshme të ripërpunimit në vend ose rajon (karton, PET, PE, PP...).

Kërkoni paketim të ricikluar.

Kërkoni paketim që është i krijuar të paktën në një përqindje me material të ricikluar.

Kërkoni nga kontraktori që të bëjë një menaxhim korrekt të paketimeve të mbetjeve të krijuara gjatë kontratës duke siguruar mbledhjen e ndarë të tyre.

Në kontratat me gjenerim të lartë të mbetjeve të ambalazhit, ndërtimit dhe punime të tilla, kërkoni nga kontraktorët të përcaktojnë një nivel minimal dhe objektiv për mbetjet e paketimit (që do të arrihet përmes një sistemi të grumullimit, ripërdorimit dhe riciklimit të paketimit).

Kriteret për aktivitetet e zyrës

Përdorni ujë rubineti ose ujë nga pajisje të mëdha.

Shmangni përdorimin e gotave të pijeve njëpërdorimshme gjatë takimeve.

Shmangni përdorimin e ambalazheve plastike të ushqimit.

Blini mallra që kanë një numër minimal paketimesh, mundësisht të riciklueshme.

Ndarjen e mbetjeve të ambalazhimit plastik në burim sipas materialeve të përdorura, duke përfshirë tipet e mbetjeve plastike (PP, PE, PS), në mënyrë që ato të mos degradohen përpara riciklimit të tyre.

Jepini përparësi cuarjes së mbetjeve për riciklim përpara se t'i hidhni ato.

Ndarja e mbetjeve në burim sipas materialeve të përdorura.

Ndarja e mbetjeve sipas materialeve të përdorura, duke përfshirë diferencimin e llojeve individuale të materialeve plastike (PP, PE, PS), në mënyrë që ato të mos degradohen përpara riciklimit të tyre.

Kërkoni një listë të përpunuesve të mbetjeve të krijuara, ndërkohë që kërkoni me përparësi riciklimin ose djegjen për përfitim të energjisë përpara depozitimit.

Kriteret për sektorin e ndërtimit

Kërkoni paketime të ripërdorëshme gjatë transportit të dërgesave; ose në kontratat me gjenerim të lartë mbetjesh, sic mund të jenë mbetjet e ndërtimit apo punëve të ndryshme, kërkoni nga kontraktorët të përcaktojnë një nivel minimal dhe objektiv të synuar për përdorimin e ambalazheve të ripërdorshëm gjatë transportit.

Përfshini një detyrim në kontratë për të ndarë mbetjet në burim.

Përfshini një detyrim në kontratë lidhur me ndërtimet, nëse është e mundur, për të përdorur materiale që nuk janë të paketuara në ambalazhe plastike (të dorëzuara në paleta, etj.)

Përfshirja e një detyrimi në kontratë për të minimizuar gjenerimin e mbetjeve nga organizimi i mirë i punës dhe përdorimi i teknikave më të mira të disponueshme.

Ndarja e mbetjeve në burim sipas materialeve të përdorura.

Ndarja e mbetjeve sipas materialeve të përdorura, duke përfshirë diferencimin e llojeve të materialeve plastike (PP, PE, PS), në mënyrë që ato të mos degradohen përpara riciklimit të tyre.

Kërkoni ndarje të plotë të komponentëve të rrezikshëm në kosha të veçantë.

Kërkoni një listë të përpunuesve të mbetjeve të krijuara, ndërkohë që kërkoni me përparësi riciklimin ose përfitimin e energjisë përpara depozitimit.

Kriteret për aktivitetet publike (festivale, aktivitete në natyrë...)

Shmangni paketimet një përdorimshe për ushqim dhe pije.

Kërkesë për përdorimin e gotave të ripërdorshme (xhami, porcelani).

Kërkesë për përdorimin e seteve të servirjes të ripërdorshme.

Kërkesë për përdorimin e paketimit të ushqimeve dhe pijeve të biodegradueshme.

Përfshini një detyrim në kontratë për ndarjen e mbetjeve në origjinë (vendosja e disa koshave të mire përcaktuar me ngjyra të ndryshme për diferencimin e mbetjeve, dhe prania vullnetarëve që shpjegojnë mënyrën e ndarjes së tyre).

Siguroni riciklimin / ndarjen/ rikuperimin e energjisë të mbetjeve pas eventit.

Ndarja e mbetjeve në burim sipas materialeve të përdorura.

Kërkoni fushata informuese për të siguruar cilësi të mjaftueshme të mbetjeve të grumbulluara (vullnetarë që shpjegojnë se ku të vendosen mbetjet specifike, fletëpalosje, postera, duke shënuar vendosjen dhe emërtimet e koshave).

Zbrazja e kohave të mbeturinave në intervale të tilla që të mos ketë tejmbushje të tyre.

Ndarja e mbetjeve sipas materialeve të përdorura, duke përfshirë diferencimin e llojeve të materialeve plastike (PP, PE, PS), në mënyrë që ato të mos degradohen përpara riciklimit të tyre.

Kërkoni një listë të përpunuesve të mbetjeve të krijuara, ndërkohë që kërkoni me përparësi riciklimin ose përfitimn e energjisë përpara depozitimit.



Kjo broshurë u përgatit në kuadër të projektit “Zbatimi pilot i kriterëve specifike të prokurimit publik me fokus parandalimin dhe minimizimin e mbetjeve plastike në Shqipëri” si pjesë e Programit të Granteve të Vogla (SGP) për Mbetjet Plastike, komponenti i parë i projektit “Veprime të mëtjeshme për adresimin e mbetjeve plastike sipas Konventës së Bazelit' (BRS-Norad-2), financuar nga Agjencia Norvegjeze për Bashkëpunim për Zhvillim (Norad).

Qershor, 2022